# PRINË "ALDI" PËR SHIKUESHMËRI

## *Sipas hulumtimeve të Strategic Marketing dhe AGB Nielsen Media cili është TV më i shikuar në Luginë të Preshevës?*

Rijad Demiri




Strategic marketing research dhe AGB Nielsen Media research me kërkesë të hulumtuesve IREX dhe USAID, kanë bërë hulumtimin e shikueshmërisë së televizioneve lokale dhe atyre rajonale.

Rezultati i këtyre hulumtimeve, i cili publikua gjatë ditës së djeshme më 13.06.2008 në selinë e agjencionit IREX, Televizioni "Aldi" në mesin e rreth 35 mijë shikuesve u radhit si televizioni më i shikuari në Luginë të Preshevës.

Në tabelën e cila u publikua dje shihet se Televizioni "Aldi" shikohet nga 49.50 % e qytetarëve në luginë të Preshevës , më pas me 30.8 % radhitet Televizioni Presheva , pastaj RTV Spektri me 18.9 % dhe Televizioni Bujanoci me 0.6 %.






Ndërkaq në nivel të shikueshmërisë rajonale Televizioni “Aldi” radhitet në vendin e 3 për shikueshmëri.

RTV “Aldi” u themelua, më 1 dhjetor të vitit 2006, ku për 18 muaj rresht bëri një punë të palodhshme duke mbajtur statusin e një televizioni të hapur për qytetarët dhe për të gjitha institucionet që veprojnë në Preshevë dhe Bujanoc.

Në syrin e kamerës së Televizionit “Aldi” për 18 muaj keni pasur rastin t'i ndjekin preokupimet dhe hallet e qytetarëve , ku ky medium ka bërë në mënyrë konstruktive informacione për qytetarët , sepse ky medium është vetëm për qytetarë.

Në bazë të kësaj transparence arriti të vlerësohet si i pari me shikueshmëri në luginë dhe i treti në rajon dhe për konstruktivitetin që ka ndaj të gjithëve vlerësohet si medium dhe merr licencën , që i jep garanci këtij mediumi për 8 vitet e ardhshme.

